



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.1152/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “KOSOVA ASFALT” SHPK - Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Rahovica Commerce SHPK & BENI Company & Mirusha Company”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakovc” me nr. të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, më datën: 22.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “KOSOVA ASFALT” SHPK - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakovc” me nr. të prokurimit 616-20-1262-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

II. VËRTETOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakovc” me nr. të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “KOSOVA ASFALT” SHPK- Ferizaj, aprovohet pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “KOSOVA ASFALT” SHPK - Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 28.12.2020 me nr. 1152/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakoc” me nr. të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 08.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Ekspertja Shqyrtuese fillimisht sqaron se, aktiviteti i prokurimit në fjalë, AK me vlerësimin e ofertave me datë 02.06.2020 fillimisht ka rekomanduar OE “Kosova Asfalt” ne rastin konkret ankuesi i tanishëm, mirpo pastaj Operatorët Ekonomik “Rahovica Commerce” SHPK dhe “Kema Company” SHPK kanë bërë ankesë në OSHP, duke pretenduar se OE “Kosova Asfalt” nuk qe i përgjegjshëm për arsye se i mungojnë certifikatat e Armiruesit dhe Latuesit dhe po ashtu Deklarata nën Betim nuk është e plotësuar sipas rregullave, përderisa me shqyrtimin e ankesave të Operatorëve në fjalë, OSHP nxjerr një vendim me nr. 611-612/20 dt 09.10.2020.

Në lidhje me pretendimin ankimor se deklarata nën betim nuk e plotëson kriterin sipas nenit 65 të LPP-se, pasi që deklarata nën betim duhet të jetë e nënshkruar nga pronari i kompanisë në këtë rast nënshkrimi është nga pronari, kurse personi i shënuar në deklarata nën betim nuk është pronar as drejtor i kompanisë dhe as nuk posedon autorizim në dosjen e tenderit, po ashtu vlen të ceket se i njëjti person i shënuar në deklaratën nën betim Bujar Shabani është pronar i kompanisë Bageri e cila është ofertues në këtë procedurë, ku kemi të bëjmë me personin e njëjtë i cili ka ofertuar dy here me kompani të ndryshme. Po ashtu në lidhje me këtë ka interpretim të lëshuar nga KRPP (nr. 40) nëse dikush nënshkruan në emër të dikujt tjetër pa autorizim AK gjatë rivlerësimit të kërkoj informata shtese konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se.

Paneli shqyrtues sqaron se Deklarata nën betim duhet të jetë e qartë, me të gjitha informatat e sakta në mënyrë që të saktësohet nënshkruesi, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik e që në rastin konkret nuk është e qartë, andaj edhe pretendimi ankimor është i qëndrueshem. Paneli shqyrtues sqaron se sa i përket Pyetjes në KRPP, aty bëhet fjalë për nënshkrimin, pra Deklarata e nënshkruar nga personi i pa autorizuar ose nënshkrimi PËR, ndërsa në rastin konkret Deklarata nën Betim është gabuar tek Emri ndërsa nënshkrimi është në rregull, por që edhe nga KRPP sqarohet se Deklarata nën betim duhet të jetë e kompletuar ashtu si kërkohet, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi " për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.

Pra, OE ankuesi "Kosova Asfalt" SHPK gjatë procesit të rivlerësimit shpallet i pa përgjegjshëm për arsye se Deklarata nën betim nuk është e plotësuar sipas kërkesës andaj edhe siç shihet tek vendimi i PSH 611-612/20 Deklarata nën Betim të OE "Kosova Asfalt" SHPK nuk mund të merret si e mirëqenë me gabim, andaj si e tillë e refuzon tenderin.

Ndërsa sa i përket Certifikatave për Armiruesit dhe Latuesit gjatë procesit të rivlerësimit, OE "Kosova Asfalt" i ka bashkangjitur dhe se ky pretendim gjendet i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht gjersa Vendimi i AK për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Autoriteti kontraktues me datë 17.11.2020, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik nuk ka përgjigje

From: Rrjeti i OJQ-ve AVONET <avonet.rks@gmail.com>

Sent: Ëdnesday, January 6, 2021 10:55 PM

To: Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; OSHP <oshp@rks-gov.net>; Rregullat Krpp <Rregullat.Krpp@rks-gov.net>; Osman Vishaj <osman.vishaj@rks-gov.net>; Zeke Bardhaj <Zeke.Bardhaj@rks-gov.net>; Prokurimi Prishtine <prokurimi.prishtine@rks-gov.net>

Cc: Kenan Gashi <kenan.gashi@gmail.com>; Arlind Avdyli <arlind.rks@gmail.com>; Erleta Haxhimusa <leta_nr94@hotmail.com>

Subject: Raporti i monitorimit dhe hulumtimit të të gjeturave në dosjen e tenderit me titull: “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakkovc me numër të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1.

Keni të bashkangjitur raportin e monitorimit dhe hulumtimit të të gjeturave në dosjen e tenderit me titull: “
Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakkovc me numër të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1.

Me respekt,

Kenan Gashi

Drejtor Ekzekutiv

--

Rrjeti i OJQ-ve AVONET

Rruga: Ramadan Rexhepi, (ish objekti i QAP-it),

Ferizaj/Kosovë, 70 000

Tel: +383 44 800 114, +383 44 800 343

E-mail: avonet.rks@gmail.com

Raporti:

AVONET



Rrjeti i Organizatave Joqeveritare
Netëork of Non Governmental Organisation

Adresa: Rr."Ramadan Rexhepi"ish objekti i QAP, 70 000 Ferizaj, Kosovë

e-mail: avonet.rks@gmail.com

Cel: +383 44 800 114 & +38344 800 343

Nr. REF-RHM: 1/2021

Data: 06/1/2021

Për: z. Zekë Bardhaj, Drejtor i Prokurimit në Komunën e Prishtinës

C.C: z. Blerim Dina, kryetari i OSHP,

C.C: z. Osman VISHAJ – Kryetar KRPP-së,

C.C: z. Fahri Maxhuni, Departamenti i monitorimit në KRPP,

Nga: z. Kenan Gashi, Drejtor Ekzekutiv i Rrjetit të OJQ-ve AVONET,

Lënda: Raporti i monitorimit dhe hulumtimit të të gjeturave në dosjen e tenderit me titull: “ **Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakkove me numër të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1.**”

KËRKESË

Rrjeti i OJQ-ve AVONET, gjatë monitorimit të aktivitetit të prokurimit në projektin me titullin: “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakkove me numër të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1.

Gjatë aktivitetit kemi vërejtur se konzerciumi Kosova Asfalt shpk dhe Agim Morina B.I, në aktivitetin e prokurimit të lartë cekur kanë dorëzuar kërkesë për ri shqyrtim kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues dhe gjatë monitorimit të “kërkesës për rishqyrtim të dorëzuar nga Operatoret Ekonomik” ku kanë bashkangjitur disa dokumente të quajtur DIPLOMË. AVONET gjatë procesit të monitorimit dhe hulumtimit ka dyshuar se këto DIPLOMA, nuk kanë asnjë element të një dokumenti zyrtarë dhe gjatë hulumtimit kemi identifikuar se këto DIPLOMA janë dokumente të dyshuara dhe të falsifikuara, ndërsa duke pasur dyshimet që mos është keqpërdorë vula e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe për të siguruar informacione të sakta dhe për të verifikuar të gjetur se mos janë të falsifikuara këto dokumente të cilat nuk kanë element të një dokumenti zyrtarë të lëshuara nga Institucionet e RKS-së dhe Agjensionet tjera dhe ka adresuar kërkesë për interpretim dhe verifikim të këtyre dokumenteve tek institucioni i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Qendrës për Aftësim Profesional të Prishtinës, keni të bashkangjitur diplomat dhe pytjet që keni të bashkangjitur në attachment;

Pergjigja nga Gani Ismajli, Udhëheqës i Divizionit për zhvillim të cilësise dhe Certifikimit/ APRK

te nderuar- i shiqova dokumentet per te cilat kerkohet verifikimi per rregullesin e tyre.

Ju njoftoj se asjneri nga keto dokumente nuk jane leshuar nga Qendra e aftesimit profesional ne Prishtine qe menaxhohet nga APRK/MPMS. Keto dokumente, perveq qe kane nje ngjajshmerin ne emertimin e institucionit, nuk kane te bejne me asnje element te vetemngjajshmerie me certifikatat qe leshohen ne qap Prishtine, pra keto nuk kane; llogo , vule, format te njejt, numer protokoli e as emertim te njejte te dokumentit (te ne leshohen certifikat a e jo Diploma).

Me respekt

Gani Ismajli, Udheheqes i Divizionit per zhvillim te cilesise dhe certifikimit/ APRK

Poashtu AVONET ka pranuar nje e-mail nga Drejtori i Pergjithshem i Agjencise se Punesimit te Republikes se Kosovës z. Drin Haraçia dhe z.Gani Ismajli, Udheheqës I Devizionit për zhvillim të cilësisë dhe certifikimit / APRK, ku keni të bashkangjitur përgjigjen lidhur me kërkesën e AVONET-it.

AVONET, konsideron se Operatoret Ekonomik Kosova Asphalt shpk dhe Agim Morina B.I, kanë mashtruar, falsifikuar dhe kane lajthit AK dhe këta janë ndeshur me Kodin Penal të Republikës së Kosovës me NR. 06/L-074 neni 415, keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik

1. Kushdo që me vetëdije shkel rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokumentacion të rremë, marrëveshje të fshehtë kundërligjore apo ndërmerr ndonjë veprim tjetër të paligjshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe më qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik, dënohet me gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet.

2. Personat përgjegjës apo kushdo i cili më qëllimisht dhe duke shkelur procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, nuk zbatojnë detyrimet që dalin nga kontrata e prokurimit publik me qëllim të përfitimit për vete apo duke shkaktuar dëme buxhetore, nëse karakteristikat e veprave të tjera penale nuk janë përmbushur, dënohet me gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet dhe neni 390, falsifikimi i dokumenteve, citoj:

1. Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistër tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

3. Kushdo që e kryen veprën e paraparë në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni si anëtar i grupit të njerëzve, dënohet me gjobë dhe burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, dhe neni 391, rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve ku parasheh këto shkelej të cilat janë:

1. Personi do të konsiderohet se ka kryer vepër penale të falsifikimit të dokumenteve dhe do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, nëse personi i tillë:

1.1. pa autorizim plotëson ndonjë letër, formular të zbrazët ose ndonjë formë tjetër në të cilën është vënë nënshkrimi i personit tjetër dhe plotëson deklaratën përmes së cilës krijon marrëdhënie juridike;

1.2. mashtron personin tjetër lidhur me përmbajtjen e ndonjë dokumenti dhe personi i tillë e nënshkruan këtë dokument duke menduar se nënshkruan ndonjë dokument tjetër ose dokument me ndonjë përmbajtje tjetër;


1.3. lëshon dokumentin në emër të ndonjë personi tjetër pa autorizimin e tij ose në emër të personit që nuk ekziston;


1.4. lëshon një dokument dhe pohon me nënshkrimin e vet se ka ndonjë pozitë, thirrje apo gradë edhe pse nuk ka pozitë, thirrje apo gradë të tillë, ndërsa veprimi i tillë ka ndikim substancial në vlerën e dokumentit.

Poashtu AVONET konsideron se është shkelur edhe ligji me Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS neni 99, ku parashihen funksionet dhe kompetencat e OSHP, përkatësisht paragrafi 2, ku përcaktohet se: në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumentit falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

AVONET, konsideron se kjo është një shkelje e rëndë e ligjit të prokurimit publik me nr. të ligjit 04/L-042 dhe Kodit Penal të republikës së Kosovës me nr. të ligjit 06/L074, andaj Autoriteti kontraktues duhet të veprojë dhe procedurojë për lajthitje dhe mashtrim të anëtarëve të komisionit vlerësues të tenderit dhe falsifikim të dokumenteve, duke pezulluar kontratën e projektit dhe vërtetuar për të gjeturat tona.

Me respekt,





Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave të datës 02.06.2020 për këtë aktivitet të prokurimit, fillimisht ka rekomanduar për kontratë OE “Kosova Asfalt”. Mirëpo, OE “Rahovica Commerce” SHPK dhe “Kema Company” SHPK kanë parashtruar ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se OE “Kosova Asfalt” nuk është i përgjegjshëm për arsye se i mungojnë certifikatat e Armiruesit dhe Latuesit, si dhe deklarata nën betim nuk është e plotësuar sipas rregullave. Kurse, pas shqyrtimit të ankesës, OSHP nxjerr vendimin PSH.nr.611-612/20 të datës 09.10.2020. Për pikën ankimore që ka të bëjë me deklaratën në betim, në vendimin PSH.nr.611-612/20 është konstatuar se deklarata nën betim duhet të jetë e qartë, me të gjitha informatat e sakta në mënyrë që të saktësohet nënshkruesi, përderisa në formularët standard të dosjes së tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera kërohen të dhënat mbi identifikimin e OE... Pra, OE ankuesi “Kosova Asfalt” SHPK gjatë procesit të rivlerësimit shpallet i pa përgjegjshëm për arsye se deklarata nën betim nuk është e plotësuar sipas kërkesës. Andaj, edhe siç shihet tek vendimi i Panelit Shqyrtues PSH.nr.611-612/20, deklarata nën betim e OE “Kosova Asfalt” SHPK nuk

mund të merret si e mirëqenë me gabim, andaj si e tillë e refuzon tenderin.

Ndërsa sa i përket certifikatave për armiruesit dhe latuesit gjatë procesit të rivlerësimit, OE "Kosova Asfalt" i ka bashkangjitur dhe se ky pretendim gjendet i bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me të drejtë e ka eliminuar OE ankues për shkak se deklarata nën betim nuk është e plotësuar sipas kërkesës. Kurse, sa i përket vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, Panelit Shqyrtues konsideron se autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK Prishtinë";

1x1 OE "KOSOVA ASFALT" SHPK;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.